

VENDIM
Nr. 465, datë 26.7.2023

PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË PAJISJEVE DHE TARIFAVE PËR SHPËRBLIMIN E ARSYESHËM PËR RIPRODHIMIN E VEPRAVE TË AUTORIT PËR PËRDORIM PRIVAT OSE PËRDORIM TJETËR PERSONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Tarifa për shpërblim të arsyeshëm”**, tarifa që paguhet nga prodhuesit vendas në rastin e shitjes së parë dhe/ose importuesit e pajisjeve, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal në territorin e Republikës të Shqipërisë, kundrejt Sportelit Unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve të së drejtës së autorit, bazuar në një kontratë/marrëveshje midis tyre;

b) **“Prodhues vendas dhe importues”**, çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon ose importon në Republikën e Shqipërisë pajisjet, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal;

c) **“Pajisje/materiale të reja për regjistrimin vizual dhe zanor, kasetat dhe videokasetat boshe ose çdo mjet i fiksimit të tekstit”**, kartë memorie (përveç atyre të aparateve celularë); *disc/bluray*; HDD, DVD; kasete, audio; minidisk; videoregjistrues i llojit VHS, super VHS (përveç regjistruesve për kamera portative si: video 8, digjital 8 Hi8, DVM, VHS-C, super VHS-C), D-VHS, HD videokasetë; çdo lloj i DVD ose CD boshe; televizor dhe çdo aparat me *hardisk* të brendshëm, si edhe video digjitale me memorie të brendshme, ku bëhet i mundur regjistrimi audio/video, MP3 *player*, MP4 *player*, *iPod media player* që mbështet formate: AVI, MPEG-1, MPEG-2, MPEG-4, XVID, DIVX (v3.11, v4.x, V.5x, V.6x), XVID / VCD, SVCD, DVD, ACC, WMA, WMV, ASF, MP3, MP4, WAV, IMOD dhe çdo version tjetër të ngjashëm me to për të gjitha rastet e zhvillimeve teknologjike të mëvonshme; *bluray* regjistrues; HD DVD regjistrues; audioregjistrues; minidisk regjistrues; videoregjistrues; CD regjistrues, pajisjet HI-FI që funksionojnë në mënyrë të pavarur; DVD regjistrues. pajisjet HI-FI që funksionojnë në mënyrë të pavarur; MP3 regjistrues; CD regjistrues; DVD regjistrues; kompjuter me lexues CD (përqindja vlen edhe për shumën që përfaqëson 7% të të gjithë sistemit me të cilin tregton CD writer); kompjuter me lexues DVD (përqindja vlen edhe për shumën që përfaqëson 7% të të gjithë sistemit që është shitur së bashku me DVD regjistruese); *hard disc* i jashtëm; *hard disc* i brendshëm (përqindja), aplikuar për një shumë që përfaqëson 10 (dhjetë) % të të gjithë sistemit që është shitur së bashku me *hard drive*); kartë memorie e lëvizshme; telefona që riprodhojnë zë apo audio regjistrime vizuale MP3, MP4, AAC, WMA, WAV etj., (për shembull *iPhone*) me një kapacitet ruajtje më të madh se 4 Gb;

ç) **“Pajisje/materiale të reja të fotokopjimit”**, fotokopjet, printerët, skanerët, pajisjet dhe/ose makineritë multifunkionale të tjera të ngjashme me/pa funksion fotokopjues dhe letra.

2. Ky vendim përcakton tarifat për shpërblim të arsyeshëm nga shitja e parë dhe/ose importi i pajisjeve, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal në Republikën e Shqipërisë, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 31, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar.

3. Ky shpërblim paguhet në emër dhe për llogari të Sportelit Unik nga të gjithë prodhuesit vendas në rastin e shitjes së parë dhe/ose importuesit e këtyre pajisjeve, të cilat bëjnë të mundur

riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Lista e pajisjeve dhe materialeve të reja për regjistrimin vizual dhe zanor, kasetave dhe videokasetave boshe ose çdo mjeti të fiksimit të tekstit, si dhe çdo pajisje që ofron të njëjtin efekt me regjistrimin vizual dhe zanor është përcaktuar në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Prodhuesi vendas në rastin e shitjes së parë dhe importuesi janë të detyruar të paguajnë tarifën për shpërblim të arsyeshëm kundrejt Sportelit Unik, sipas shtojcës nr. 1, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Shpërndarja e të ardhurave bëhet nga Sporteli Unik, në përputhje me pikën 1, të nenit 139, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar.

6. Tarifën për shpërblim të arsyeshëm për listën e pajisjeve/materialeve të reja për regjistrimin vizual dhe zanor, kasetave dhe videokasetave boshe ose çdo mjeti të fiksimit të tekstit është 0.5 (zero pikë pesë) %.

7. Tarifën për shpërblim të arsyeshëm llogariten sipas vlerës në % (përqindje), sipas:

a) vlerës doganore të pajisjeve/materialeve riprodhuese të importuara që bëjnë të mundur regjistrimin vizual dhe/ose zanor si dhe fiksimit të tekstit, në analog, digjital;

b) faturave mujore, pa përfshirë TVSH-në, të lëshuara nga prodhuesit vendas në Republikën e Shqipërisë.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vendos në dispozicion të Sportelit Unik informacionin e nevojshëm për përlogaritjen e tarifave të shpërblimit të arsyeshëm për importet në Republikën e Shqipërisë të pajisjeve, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal. Ky informacion përfshin:

a) numrin e deklaratave doganore (import);

b) datën e deklaratës doganore;

c) vlerën doganore (vlera statistikore);

d) NUIS-in e subjektit importues.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton ministrinë përgjegjëse për të drejtat e autorit dhe Sportelin Unik për kodet tarifore të mallrave të listuara në shtojcat 1 dhe 2.

10. Shkëmbimi i të dhënave, të përcaktuara në pikat 8 dhe 9, të këtij vendimi, kryhet bazuar në një marrëveshje të lidhur, ndërmjet organeve kompetente doganore dhe ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit.

11. Tarifën për shpërblim të arsyeshëm për përdorim privat ose përdorim tjetër personal për listën e pajisjeve/materialeve të reja për regjistrimin vizual dhe zanor, kasetave dhe videokasetave boshe ose çdo mjeti të fiksimit të tekstit paguhet çdo muaj, deri në 30 (tridhjetë) ditë të muajit pasardhës në llogarinë bankare të Sportelit Unik.

12. Prodhuesi vendas, i cili prodhon pajisjet/materialet e reja për regjistrimin vizual dhe zanor, kasetat dhe videokasetat boshe ose çdo mjet të fiksimit të tekstit, ka detyrimin të njoftojë dhe t'i japë informacionin e nevojshëm Sportelit Unik, me qëllim lidhjen e kontratës ose marrëveshjes dhe në vijim kryerjen e pagesës së tarifës për shpërblim të arsyeshëm.

13. Sporteli Unik llogarit dhe përcakton shumën për shpërblim të arsyeshëm që do të paguhet nga importuesi dhe/ose prodhuesit vendas, në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe prodhuesit vendas.

14. Tarifën për shpërblim të arsyeshëm për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, në përputhje me shkronjën “c”, të pikës 5, të nenit 31, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, janë të detyrueshme të paguhet me rastin e shitjes së parë nga prodhuesit në Republikën e Shqipërisë dhe/ose nga importuesit e çdo pajisjeve/materiali të ri të fotokopjimit të Sportelit Unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve të së drejtës së autorit. Shpërndarja e të ardhurave bëhet nga Sporteli Unik në përputhje me pikën 2, të nenit 139, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar.

15. Lista e pajisjeve/materialeve, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal nëpërmjet fotokopjimit në letër ose në çdo teknikë tjetër riprodhimi, që njësohet dhe ka të njëjtin efekt me fotokopjimin, përcaktohet në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

16. Tarifat për shpërbllim të arsyeshëm për listën e pajisjeve/materialeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 2 është 0.5 (zero pikë pesë) % .

17. Vlera në % (përqindje) e parashikuar në pikën 16, të këtij vendimi, llogaritet, sipas rastit, nëpërmjet:

- a) vlerës doganore për çdo pajisje/makineri të importuar në Republikën e Shqipërisë;
- b) faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit, pa përfshirë TVSH-në për çdo pajisje/makineri, të prodhuar në Republikën e Shqipërisë.

18. Pikat 8, 9, 10, 11 e 12, të këtij vendimi, zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për prodhuesit dhe importuesit e pajisjeve/materialeve, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal nëpërmjet fotokopjimit në letër ose në çdo teknikë tjetër riprodhimi që njësohet dhe ka të njëjtin efekt me fotokopjimin.

19. Ngarkohen ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit dhe Sporteli Unik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1

| Shpërblimi në % (përqindje) | Pajisje/materiale të reja për regjistrimin vizual dhe zanor, kasetat dhe videokasetat boshe ose çdo mjet i fiksimit të tekstit | Mënyra e llogaritjes | |
|--------------------------------|--|----------------------------|---|
| | | Për importuesit nëpërmjet: | Prodhuesit vendas nëpërmjet: |
| 0.5% | <p>Suporte/njësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kartë memorie (përveç atyre të aparateve celularë); 2. Disc/Bluray; 3. HDD,DVD; 4. Kasete, audio; 5. Minidisk; 6. Video regjistruar i llojit VHS, super VHS (përveç regjistruarve për kamera portative si: video 8, digjital 8 Hi8, DVM, VHS-C, Super VHS-C), D-VHS, HD video kasetë; 7. Çdo lloj i DVD ose CD boshe; 8. Karta e memories; 9. Televizor dhe çdo aparat me <i>hardisk</i> të brendshëm si edhe video digjitale me memorie të brendshme, ku bëhet i mundur regjistrimi audio / video, MP3 <i>player</i>, MP4 <i>player</i>, <i>iPod media player</i> që mbështet formate: AVI, MPEG-1, MPEG-2, MPEG-4, XVID, DIVX (v3.11, v4.x, V.5x, V.6x), XVID / VCD, SVCD, DVD, ACC, WMA, WMV, ASF, MP3, MP4, WAV, IMOD dhe çdo version tjetër të ngjashëm me to për të gjitha rastet e zhvillimeve teknologjike të mëvonshme. 10. <i>Bluray</i> regjistruar; 11. HD DVD regjistruar; 12. Audio regjistruar; | Vlerës doganore | Faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit, pa përfshirë TVSH-në, për çdo pajisje/makineri të prodhuar në Republikën e Shqipërisë |

| | | | |
|-------|--|--|--|
| 0.5 % | <p>13. <i>Minidisk</i> regjistruet;</p> <p>14. Video regjistruet;</p> <p>15. CD regjistruet, pajisjet HI-FI që funksionojnë në mënyrë të pavarur;</p> <p>16. DVD regjistruet pajisjet HI-FI që funksionojnë në mënyrë të pavarur;</p> <p>17. MP3 regjistruet;</p> <p>18. CD regjistruet;</p> <p>19. DVD regjistruet;</p> <p>20. Kompjuterat me lexues CD; (përqindja vlen edhe për shumën që përfaqëson 7% të të gjithë sistemit me të cilin tregton CD <i>writer</i>)</p> <p>21. Kompjuter me lexues DVD; (përqindja vlen edhe për shumën që përfaqëson 7% të të gjithë sistemit që është shitur së bashku me DVD regjistruet)</p> <p>22. <i>Hard disk</i> i jashtëm;</p> <p>23. <i>Hard disk</i> i brendshëm; (Përqindja aplikuar për një shumë që përfaqëson 10% të të gjithë sistemit që është shitur së bashku me <i>hard drive</i>);</p> <p>24. Kartë memorie e lëvizshme;</p> <p>25. Telefona që riprodhojnë zë apo audio regjistrime vizuale MP3, MP4, AAC, WMA, WAV etj. (për shembull <i>iPhone</i> etj.) me një kapacitet ruajtje më të madh se 4 Gb.</p> | | |
|-------|--|--|--|

SHTOJCA NR. 2

| Shpërblimi në % (përqindje) | Pajisje/ materiale të reja të fotokopjimit | Mënyra e llogaritjes | |
|--------------------------------|---|----------------------------|--|
| | | Për importuesit nëpërmjet: | Prodhuesit vendas nëpërmjet: |
| 0.5 % | <p>1. Fotokopjet;</p> <p>2. Printerat;</p> <p>3. Skanerat;</p> <p>4. Pajisjet/makineritë multifunksionale të tjera të ngjashme me funksion fotokopjues.</p> <p>5. Letër</p> | Vlerës doganore | Faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit, pa T.V.SH, për çdo pajisje/makineri të prodhuar në Republikën e Shqipërisë |

